



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr.161, Datë 21.12.2012

PËR

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 21.11.2007 “PËR
PROÇEDURAT E INSPEKTIMIT NË SUBJEKTET FINANCIARE JO-BANKARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 23 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe nenit 128, të Ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e disa ndryshimeve në Udhëzimin nr. 2, datë 21.11.2007 “Për procedurat e inspektimit në subjektet financiare jo-bankare”, sipas tekstit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI

Në Udhëzimin nr. 2, datë 21.11.2007 “Për procedurat e inspektimit në subjektet financiare jo-bankare”, të bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 1.3 “Përkufizime” ,

- të shtohet pika e) “Letër për drejtuesit” nënkupton raportin përfundimtar të inspektimit.
- Të zëvendësohet termi: “raporti përfundimtar” me termin “Letër për drejtuesit”

2. Pika 2.1.7

Titulli “ *Hartimi i raportit të inspektimit*”, të ndryshohet dhe të bëhet: “ *Hartimi i projekt raportit të inspektimit*”

Paragrafi 3, është:

“Grupi i inspektimit përgatit projekt raportin brenda një jave nga data e përfundimit të inspektimit dhe ja paraqet atë N/Kryetarit të mbikëqyrjes dhe disiplinimit.”

Të bëhet:

“Grupi i inspektimit përgatit projekt raportin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e përfundimit të inspektimit dhe ja paraqet atë N/Kryetarit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit.”

3. Pika 2.1.8 Dërgimi i projekt raportit tek subjekti i inspektuar dhe marrja e opinionit është:

“... njëra kopje i dërgohet subjektit financiar jo-bankar për tu nënshkruar nga Drejtuesi brenda 3 ditë pune ose të paraqesin kundërshtimet përkatëse...”

Të bëhet:

“...njëra kopje i dërgohet subjektit financiar jo-bankar për të paraqitur kontestimet/ kundërshtimet përkatëse mbi projekt raportin e inspektimit, nëse kanë të tilla, brenda 8 (tetë) ditë pune nga dita e njoftimit të projekt raportit.

4. Pika 2.1.9

Paragrafi I parë është: “*Pas nënshkrimit të projekt raportit dhe shyqrtimit të observacioneve bashkëngjitur, nëse ka, grupi i inspektimit harton raportin përfundimtar.*”

Të bëhet:

“Pas shyqrtimit të kundërshtimeve/ kontestimeve të projekt raportit të inspektimit, nëse ka, grupi i inspektimit harton Letrën për Drejtuesit. Periudha që nga përfundimi i depozitimit të observacioneve deri në dorëzimin e letrës për drejtuesit, nuk duhet të jetë më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune -.”
